

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHITJA KOKËDHIMA KUNDËR SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 55159/16)

VENDIM

Neni 3 P1 – Kandidimi në zgjedhje – Ndërprerje e mandatit si Deputet i Parlamentit nga Gjykata Kushtetuese me arsyetimin se kjo ishte e papajtueshme me përfshirjen e tij në aktivitete biznesi me anë të një kompanie tek e cila ai ishte aksioner i vetëm dhe që tërhiqte të ardhura që buronin nga kontrata me organet e Shtetit – Asnjë problematikë, në lidhje me përdorimin e ligjeve dhe praktikës së zbatueshme – Kërkuesi nuk mori të gjitha masat e nevojshme për të ndërprerë konfliktin e interesit që vazhdonte në momentin e marrjes së mandatit të tij – Masë e kundërshtuar mjaftueshëm e parashikueshme dhe jo arbitrare

STRASBURG

11 qershor 2024

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë sipas parashikimeve të nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Kokëdhima kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Jolien Schukking, *Kryetar*,
Georgios A. Serghides,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Andreas Zünd,
Oddný Mjöll Arnardóttir,
Diana Kovatcheva, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *sekretar i Seksionit*,
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 55159/16) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), nga një shtetas shqiptar, z. Koço Kokëdhima (kërkuesi), më 15 shtator 2016;

vendimin për të bërë me dije Qeverinë Shqiptare (Qeveria) për ankesat në mbështetje të nenit 8 të Konventës dhe nenit 3, të Protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me ndërprerjen e mandatit të kërkuesit si Deputet i Parlamentit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

vërejtjet e palëve,

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 21 maj 2024,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

HYRJE

1. Kërkesa ka të bëjë me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për të ndërprerë mandatin e kërkuesit si Deputet i Parlamentit (DP) me arsyetimin se mandati nuk pajtohej me përfshirjen e tij në aktivitete biznesi me anë të një kompanie, “Abissnet” sh.a. Kërkuesi u ankua se largimi i tij nga detyra shkelte të drejtën e tij për të kryer rolin e tij parlamentar, në kundërshtim me garancitë e

parashikuara në nenin 3, të Protokollit nr. 1 të Konventës, dhe se dëmtonte reputacionin e tij në shkelje të nenit 8 të Konventës.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1959 dhe jeton në Tiranë. Ai u përfaqësua nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron ligjin në Tiranë.

3. Qeveria u përfaqësua nga Agjenti i saj, z. A. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes, sipas parashtrimeve të palëve, mund të përmbledhen si më poshtë vijon.

5. Kërkuesi ishte aksioneri i vetëm i kompanisë aksionare private “Abissnet” sh.a., në periudhën nisur nga data 29 tetor 1999, kur kompania u regjistrua në Tiranë, dhe deri më 6 shkurt 2014, kur ai i shiti aksionet e tij. Në periudhën 3 janar deri më 2 gusht 2013, kompania lidhi kontrata me një sërë autoritetesh publike për të ofruar internet dhe shërbime telefonike fikse.

6. Më 23 qershor 2013, në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, ku kërkuesi kandidoi.

7. Më 25 korrik 2013, kërkuesi kërkoi këshillim nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konflikt të Interesave (Inspektorati i Lartë), në mbështetje të nenit 42/1/f, të ligjit nr. 9367, të datës 7 prill 2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*” (ligji nr. 9367/2005), për konfliktin e mundshëm të interesit që mund të lindte nga pozita e tij si aksioner i kompanisë “Abissnet” sh.a., në rast se do të zgjidhej si Deputet i Parlamentit.

8. Më 31 korrik 2013, kërkuesi u hoqi dorë nga pozicioni si drejtues i “Abissnet” sh.a.

9. Më 2 gusht 2013, zgjedhja e kërkuesit u certifikua nga Kolegji Zgjedhor.

10. Në një letër të datës 7 gusht 2013, Inspektorati i Lartë e udhëzoi kërkuesin se ishte përgjegjësia e tij që të parandalonte çdo konflikt interesi dhe se mund të kërkonte këshillim nga Parlamenti, që vlerësonte çdo rast të një konflikti të mundshëm interesi, dhe e këshillonte se çfarë masash duhej të ndërmerreshin. Gjithashtu, Inspektorati i Lartë e këshilloi kërkuesin se nëse dëshironte që të kryhej një hetim administrativ ndaj pozitës së tij, ai do të duhej të paraqiste një autorizim me shkrim për këtë qëllim. Inspektorati i Lartë e informoi kërkuesin se, në përputhje me procedurën juridike të konsoliduar, ai do të kontrollohej nga Inspektorati i Lartë për çdo konflikt interesi, pavarësisht kontrolleve të bëra nga autoritetet parlamentare. Kontrollat ndaj zyrtarëve realizoheshin brenda një viti nga paraqitja e deklarimeve të tyre të interesave privatë dhe të atyre të personave të lidhur me ta.

11. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi iu drejtua Kryetarit të Parlamentit për situatën e tij.

12. Në një letër të datës 18 tetor 2013, Kryetari i Parlamentit informoi kërkuesin se Burimet Njerëzore dhe Drejtoria e Shërbimit të Deputetëve të Parlamentit ishte organi i duhur për të trajtuar çështjet, në lidhje me hetimin e konfliktit të interesave. Shërbimi Juridik Parlamentar ofronte udhëzim mbi ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave gjë që mund të ishte e dobishme për deklarin e pasurive dhe interesave të tij, që kërkuesi do të duhej ta bënte përpara se të fillonte mandatin si deputet. Gjithashtu, Inspektorati i Lartë informoi kërkuesin se ai mund të kërkonte këshillim nga Inspektorati i Lartë për atë se çfarë e përbënte një konflikt interesi, sipas parashikimit të nenit 42/1/f, të ligjit nr. 9367/2005.

13. Më 6 shkurt 2014, kërkuesi ia shiti aksionet e tij në “Abissnet” sh.a. një kompanie tjetër, dhe më 7 shkurt 2014, kontrata e shitjes u regjistrua pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

14. Në shkurt 2015, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, tek i cili bënin pjesë më shumë se një e dhjeta e deputetëve, paraqiti një kërkesë në Parlament, në mbështetje të nenit 73 të Kushtetutës, duke i kërkuar Parlamentit që të referonte pyetjen nëse pozicioni i kërkuesit si Deputet i Parlamentit nuk ishte i pajtueshëm me faktin se ai kishte qenë aksioner i “Abissnet” sh.a.

15. Më 10 mars 2016, Parlamenti e referoi çështjen pranë Gjykatës Kushtetuese.

16. Në vendimin e saj nr. 32/2016, të datës 3 qershor 2016, Gjykata Kushtetuese e shpalli pozicionin e kërkuesit si Deputet i Parlamentit të papajtueshëm me pozicionin e tij të mëparshëm si aksioner i vetëm i “Abissnet” sh.a. Gjykata Kushtetuese gjykoj se kërkuesi kishte vepruar në kundërshtim me nenin 70/3 të Kushtetutës, që parashikonte se Deputetëve nuk u lejohej të angazhoheshin në aktivitete fitimprurëse që gjeneronin të ardhura nga pasuritë publike.

Gjykata Kushtetuese nuk ra dakord me vonesën prej gjashtë muajsh të kërkuesit në zgjidhjen e konfliktit të interesit, dhe theksoi se edhe pse kompania e kërkuesit nuk kishte lidhur marrëveshje me ndonjë autoritet publik pas datës 2 gusht 2013, ajo kishte vijuar të merrte pagesa nga këto autoritete sipas kontratave që ekzistonin paraprakisht. Ajo gjykoi se kishte ekzistuar një konflikt i interesit sipas interpretimit të nenit 70 § 3 të Kushtetutës midis pozicionit të kërkuesit si Deputet i Parlamentit dhe pozicionit të tij si aksioner i kompanisë.

Gjykata kundërshtoi argumentet e kërkuesit se:

i. testimi përkatës do të duhej të ishte nëse kompania kishte lidhur kontrata të reja me autoritetet publike pas datës 2 gusht 2013, gjë të cilën ajo nuk e kishte bërë;

ii. ai kishte hequr dorë nga interesat e tij në kompani përpara përfundimit të vitit financiar përkatës dhe në këtë mënyrë, nuk kishte marrë asnjë dividend nga aktivitetet e kompanisë gjatë periudhës gjashtëmujore në shqyrtim;

iii. çdo përfitim ishte bërë vetëm nga kompania, që ishte një subjekt juridik i ndryshëm dhe i shkëputur nga kërkuesi;

iv. shkarkimi i tij nga detyra do të dëmtonte reputacionin e tij, duke shkaktuar shkelje të nenit 8 të Konventës dhe do të ndërhynte në të drejtën e tij për të shërbyer si Deputet dhe në të drejtën e votuesve për t'u përfaqësuar nga një kandidat i zgjedhur prej tyre.

17. Pjesa përkatëse e vendimit të Gjykatës Kushtetuese përcakton si më poshtë:

“Dispozita që rregullon konfliktet e interesit të Deputetëve (...) garanton se do të kontrollohen parimet e ndarjes së pushteteve, pavarësia në ushtrimin e detyrës së mandatit parlamentar dhe shmangia e konfliktit të interesit.

Legjislatori kushtetues ka vendosur se rregullimi i konflikteve të interesit duhet të udhëhiqet nga ligje të posaçme, ndërsa neni 70 § 3 i Kushtetutës parashikon se funksioni i një Deputeti është i papajtueshëm me kryerjen e një aktiviteti fitimprurës, që gjeneron të ardhura nga pasuritë e Shtetit.

Ky ndalim është shprehur qartazi dhe pa ekuivoke nga legjislatori kushtetues, që synonte eliminimin e të gjitha situatave që mund të bënin që një Deputet ta shihte pozicionin e tij si (...) një mundësi e mirë për të rritur të ardhurat e tij private (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 7, të datës 24 shkurt 2016).

Papajtueshmëria ka dy aspekte kryesore: së pari, ekziston ndalimi për ushtrimin [njëkohësisht] të dyja funksioneve publike; dhe, së dyti, ekziston ndalimi për ushtrimin [njëkohësisht] të një funksioni publik dhe të një funksioni privat të një natyre ekonomike (ose të ndryshëm).

Në të dyja rastet, ndalimi për ushtrimin e dy funksioneve synon parandalimin e një personi ose organi që të ketë pushtete të mbivendosur, duke shmangur në këtë mënyrë shkeljen e parimit të ndarjes dhe balancës së pushteteve, dhe për pasojë të shtetit të së drejtës.

Ndalimi për ushtrimin e më shumë se një funksioni shërben edhe si garanci për angazhimin e plotë dhe të pazezruar të një zyrtari në realizimin e detyrës së ndërmarrë prej tij, gjë që do të reduktohej ose do të bëhej e pamundur prej angazhimit të kërkuar për shkak të realizimit të njëkohësisht të një funksioni tjetër nga ai zyrtar.

[Rregullat për] konfliktet e interesit mbrojnë ushtrimin e mandatit të një Deputeti dhe garantojnë paanshmërinë e deputetëve të zgjedhur (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 44, të datës 7 tetor 2011).

Koncepti i paanshmërisë passjellë ndalimin për mbajtjen e më shumë sesa një detyre ose funksioni dhe është e parëndësishme nëse zyrtari në fjalë [merr] përfitime për shkak të pozicionit të tij ose [ekziston] një konflikt midis detyrës së tij [si zyrtar] dhe interesave të tij privatë. Fakti i ushtrimit të dy funksioneve ose detyrave (publike-publike, publike-private) mjafton që ai të jetë në shkelje, në lidhje me këtë ndalim. Gjykata [Kushtetuese] thekson se në thelb të nenit 70 § 3 të Kushtetutës gjendet një prej parimeve bazë të ushtrimit të funksioneve publike, mbështetur në parimin: një pagë ose shpërblim për një detyrë ose funksion.

Edhe në rastin kur një zyrtari i lejohet të mbajë dy detyra/funksione publike, ai ka të drejtën të marrë [vetëm] një pagë/shpërblim.

Nëse një Deputet i Parlamentit, përveç pagës së tij, merr çfarëdo të ardhure tjetër nga buxheti i Shtetit për profesionin e tij primar, atëherë, do të shkelje ky parim. Parimi i shërbimit më të mirë të mundshëm ndaj njerëzve dhe parimi i demokracisë shërbejnë atëherë kur çdo zyrtar publik i kushton të gjithë vëmendjen dhe kohën e tij përmbushjes së rolit për të cilin është zgjedhur ose emëruar, dhe të cilin ai e ka pranuar në mënyrë të lirë. E kundërta e këtij parimi natyrshëm do të sillte [rrezikun për ngritjen] e dyshimeve të arsyeshme në mendjen e publikut për cilësinë e përfaqësimit të tij (shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 44, të datës 7 tetor 2011).”.

Gjykata Kushtetuese vlerëson si më poshtë, në lidhje me datën se kur filloi konflikti i interesit:

Me nisjen e mandatit të një Deputeti, Gjykata [Kushtetuese] gjykon se pasojat juridike të mandatit [të një anëtarit] hyjnë në fuqi në momentin kur kandidati shpallet Deputet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Nga ai moment dhe në vijim, atij i kërkohet që të përmbushë të gjitha kërkesat kushtetuese dhe juridike që vijnë si pasojë e ndalimit nga ushtrimi i aktiviteteve të tjera dhe detyrimi për të bërë publike interesat e tij financiar, sipas parashikimit në nenin 70 të Kushtetutës dhe në ligje të tjerë.

Pushteti dhe detyrat e një Deputeti lidhen me funksionin e Parlamentit, pasi deputeti duhet të jetë Deputet si një parakusht për vet mandatin, por pozicioni i një deputeti nuk fitohet në Parlament: ai fitohet gjatë procesit të zgjedhjeve ku votuesit shprehin në mënyrë të lirë preferencat e tyre midis kandidatëve. Momenti kur një Deputet bën betimin parlamentar shënon fillimin e ushtrimit të detyrës së tij si Deputet dhe jo fillimin e pushteteve dhe funksioneve të tij.

Gjykata [Kushtetuese], në vendimin mbi nenin 70 § 3 të Kushtetutës, gjykon se kërkesa për të mos bërë përfitime/të ardhura nga pasuritë e Shtetit rrjedh drejtpërdrejtë nga ky parashikim, që ndalon shprehimisht jo vetëm ushtrimin e aktiviteteve fitimprurëse të lidhura me pronën e Shtetit ose qeverinë lokale, por edhe marrjen e pronësisë së kësaj prone pavarësisht mënyrës se si fitohet kjo pronë.

Gjykata [Kushtetuese] vëren se kontratat e lidhura midis palëve për ofrimin e internetit dhe shërbimeve të telefonisë fikse ishin kontrata që nuk do të ekzekutoheshin plotësisht në mënyrë të menjëhershme por që do të realizoheshin me kalimin e kohës. Për pasojë, detyrimet e palëve sipas këtyre kontratave vijonin edhe pasi [kërkuesi] të fillonte detyrën si Deputet.

Gjykata [Kushtetuese] konstaton se pavarësisht fakteve se këto kontrata ishin lidhur përpara shpalljes [së rezultateve të zgjedhjeve] dhe se kompania “Abissnet” sh.a. nuk kishte marrë pjesë në ndonjë procedurë prokurimi dhe nuk kishte lidhur kontrata të tjera me institucione shtetërore që prej datës 2 gusht 2013, nga këndvështrimi kushtetues, këto fakte nuk e përjashtonin Deputetin nga ndonjë përgjegjësi, pasi në procedurat konkrete ishte pranuar dhe provuar se pavarësisht pikës në të cilën ishin krijuar apo kishin filluar të operonin marrëdhëniet midis palëve, kompania në të cilën z. Koço Kokëdhima ishte aksioner i vetëm vijonte të merrte të ardhura nga pasuritë e Shtetit, duke përfshirë periudhën në të cilën ai kryente detyrën e Deputetit.

Pas datës 2 gusht 2013, kur Koço Kokëdhima u shpall i zgjedhur, kompania vijonte të merrte të ardhura nga kontratat që kishte lidhur më herët, duke përfshirë pagesat e bëra për kompaninë nga institucionet shtetërore.

Neni 70 § 3 i Kushtetutës nuk mund të interpretohet i izoluar nga përmbajtja e nenit 70 në tërësinë e tij, që kryesisht synon shmangien e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike dhe përcakton rregullat, mjetet, metodat, procedurat, përgjegjësitë dhe kompetencat për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e [personave përgjegjës] në rastet e konflikteve të interesit, referuar ligjit nr. 9367/2005.

Gjykata [Kushtetuese] thekson se edhe pse nuk i takon asaj të përcaktojë apo të ofrojë udhëzime për masat ose veprimet specifike që do të duhej të merreshin nga Deputetët përpara marrjes së detyrës për të shmangur konfliktin e interesave në të ardhmen, ajo gjykon se është me vend që të theksojë se është detyra e Deputetëve që në përputhje me të gjithë kuadrin kushtetues dhe juridik të marrin masat e nevojshme për të respektuar detyrimet që kanë si Deputetë.”.

Për sa i përket sjelljes së kërkuesit pas zgjedhjes së tij, Gjykata Kushtetuese paraqiti gjetjet e mëposhtme:

“Gjykata [Kushtetuese] thekson se në kohën kur ai u bë Deputet - dhe pavarësisht faktit se ai ishte në dijeni për të gjitha kontratat midis kompanisë dhe institucioneve shtetërore, dhe përfitimeve që vinin prej atyre kontratave - Koço Kokëdhima, si aksioner i kompanisë “Abissnet” sh.a., nuk mori masat e nevojshme për të shmangur konfliktin e interesave përpara se të fillonte funksionin si Deputet. Kompania vijonte të merrte të ardhura teksa ai ushtronte mandatin deri më 6 shkurt 2014.

Pretendimi i kërkuesit se neni 70 § 3 i Kushtetutës i referohet termit “përfitime” të një Deputeti dhe jo faturave të një personi juridik që ishte ky deputet, dhe se ai, teksa ishte një Deputet, nuk kishte marrë ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë si aksioner i kompanisë, pasi kompania nuk kishte deklaruar ndonjë dividend nga përfitimet që kishte bërë nga pagesat e bëra prej institucioneve shtetërore, ishte i papranueshëm edhe nga aspekti kushtetues.

Gjykata [Kushtetuese] konstaton se neni 70 § 3 i Kushtetutës dhe jurisprudenca kushtetuese nuk bëjnë dallime midis personave juridikë dhe fizikë ose midis aktiviteteve të kryera në mënyrë të veçantë nga këta persona juridikë, dhe nuk parashtrajnë kërkesën që ndalimi në fjalë të ketë fuqi në rastin kur një Deputet të ketë përfitime të drejtpërdrejta nga aktiviteti konkret.

Edhe nëse kërkuesi nuk përfitonte në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kontratat e lidhura nga kompania në të cilën ai ishte aksioner i vetëm, pasi të ardhurat e përftuara nuk depozitoheshin në llogarinë e tij si person fizik, ai, sidoqoftë, në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, përfitonte nga këto të ardhura pasi ato rrisnin kapitalin e kompanisë dhe, për pasojë, vlerën e aksioneve të tij, që nënkuptonte se aktivitetet e kompanisë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ishin fitimprurëse për aksionerin.

Edhe nëse një aktivitet ekonomik ushtrohet nga një Deputet si person fizik ose në ndonjë formë tjetër brenda një kompanie në të cilën ai merr pjesë, nga aspekti kushtetues është e rëndësishme që aktiviteti të mos gjenerojë të ardhura nga pasuritë e Shtetit ose qeveria lokale, dhe që Deputeti të mos përfitojë pasuri shtetërore, pavarësisht qëllimit për të cilin pasuritë mund të përdroshin, ose destinacionit përfundimtar të të ardhurave të përftuara.

Mbështetur në sa më sipër, Gjykata Kushtetuese gjykon se veprimet e Deputetit Koço Kokëdhima ishin në konflikt me rolin e tij si Deputet, në kundërshtim me nenin 70 § 3 të Kushtetutës.”.

18. Në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, që është shkalla e vetme dhe përfundimtare në këto çështje, kërkuesi i ndalohej të vazhdonte të ishte një Deputet.

KUADRI DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. LIGJI I BRENDSHËM

A. Kushtetuta

19. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës parashikojnë si në vijim:

“Neni 70

1. Deputetët përfaqësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.
2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.
3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të fitojnë pasuri prej tyre.
4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

Neni 71

1. Mandati i deputetit fillon ditën që ai shpallet i zgjedhur nga komisioni përkatës i zgjedhjeve.
2. Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm, sipas rastit:
(...)
c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë, të parashikuara në nenet 69, 70 paragrafët 2 dhe 3;
(...).”.

B. Ligji nr. 9367 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të datës 7 prill 2005, i ndryshuar (ligji nr. 9367/2005)

20. Dispozitat përkatëse të ligjit nr. 9367/2005 parashikojnë, si më poshtë:

“Neni 3

Përkufizime

1. “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike.

(...)

“konflikti i vazhdueshëm i interesit” është gjendja, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen.

(...)

Neni 6

Mënyra e kryerjes së detyrave dhe detyrimi për parandalimin e konfliktit të interesit

1. Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët.

2. Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.

Neni 21

Ndalimi i lidhjes së kontratave

1. Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.

Neni 28

Kufizimet për deputetin

Deputeti:

- a) nuk mund të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse;
- b) nuk mund të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar, si dhe të konsulentit, agjentit a përfaqësuesit të organizatave të përcaktuara në shkronjën “a” të këtij neni dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër;
- c) nuk mund të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg.

[...]

Neni 37

Mënyrat bazë të trajtimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave

1. Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

- a) duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë;
- (...)
- c) duke dhënë dorëheqjen nga detyrat, funksionet apo angazhimet private, që janë në konflikt me funksionin e tij publik;
- ç) duke dhënë dorëheqjen nga funksioni publik, veçanërisht në kushtet e lindjes së konflikteve të vazhdueshme të interesit.

2. Zyrtari njofton eprorin ose institucionin epror, sipas rastit, për zgjidhjen e sugjeruar ose të marrë dhe provon e dokumenton këtë zgjidhje.

3. Pavarësisht zbatimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni, zyrtari nuk çlirohet nga përgjegjësia e rënies në konflikt interesi, kur masat e marra nga vetë ai nuk rezultojnë të frytshme në parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit.

Neni 38

Zgjidhja e rasteve të veçanta të konfliktit të vazhdueshëm të interesave

1. Për kategoritë e zyrtarëve, të përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, kur trajtimi dhe zgjidhja e konfliktit të vazhdueshëm të interesit nuk mund të arrihet nëpërmjet mënyrave të dhëna në nenin 37 të këtij ligji, që zyrtari të vazhdojë të qëndrojë në të njëjtin funksion, duhet detyrimisht:

(...)

- c) të transferojë të drejtat e zotërimit aktiv të aksioneve apo të pjesëve në kapital që zotëron te një person tjetër...
3. Transferimi, sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, ose tjetërsimi, sipas pikës 2 të këtij neni, kryhet sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se 2 muaj nga çasti i lindjes së detyrimit. Zyrtari njofton dhe dokumenton përmbushjen e këtij detyrimi menjëherë, por jo më vonë se 15 ditë nga kryerja e këtij veprimi.

4. Afatet e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij neni mund të shtyhen nga eprori ose institucioni epror, kur zyrtari paraqet shkaqe të arsyeshme për vonesën. Në çdo rast, arsytet e shtyrjes dhe afatet e reja regjistrohen dhe dokumentohen, por këto afate nuk mund të jenë asnjëherë më shumë se dyfishi i afateve të përcaktuara më sipër, me përjashtim të rasteve kur shtyrja diktohet nga afatet procedurale të detyrueshme, të përcaktuara nga Kushtetuta, nga ligjet procedurale, legjislativi tregtar, dhe/ose nga rregulloret e institucioneve publike për lëshimin e dokumenteve zyrtare dhe/ose kryerjen e veprimeve juridike, ose kur afati shtyhet për shkak të nevojës së Autoritetit të Konkurrencës, për të vlerësuar pozitën dominuese në treg të një shoqërie.

[...]

7. Nëse zyrtari ose personi i lidhur nuk është i gatshëm të zbatojë kërkesat e pikave të këtij neni, atëherë zyrtari është i detyruar të japë dorëheqjen nga funksioni, brenda afateve të përcaktuara në këtë nen.

[...]

Neni 42

Kompetencat e Inspektoratit të Lartë dhe Deklarimit, dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

1. Inspektorati i Lartë, me cilësinë e autoritetit qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, kryen detyrat dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

(...)

f) këshillimin e zyrtarëve të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin periodik të interesave.”

C. Ligji nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i datës 14 prill 2008, i ndryshuar

21. Dispozitat përkatëse të ligjit nr. 9901, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i datës 14 prill 2008, i ndryshuar parashikon si më poshtë:

“Neni 76

Shpërndarja e fitimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.”

II. PRAKTIKA GJYQËSORE E BRENDSHME

Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese për nenin 70 të Kushtetutës

22. Në vendimin e saj nr. 44, të datës 7 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese gjykon se pozicioni i I. B. si Deputet nuk ishte i pajtueshëm me pozicionin e tij si aksioner i një kompanie që kishte lidhur kontrata me autoritete publike në periudhën midis zgjedhjes së tij dhe bërjes së betimit parlamentar prej tij, që ishte shtyrë për një periudhë të konsiderueshme. Pjesa përkatëse e atij vendimi parashikon si më poshtë:

“Gjykata [Kushtetuese] gjykon se:

i. [mandati] i një Deputeti fillon nga momenti kur shpallet rezultati përfundimtar i zgjedhjeve dhe vazhdon deri në krijimin e parlamentit të radhës, që është, seanca e tij e parë parlamentare;

ii. një Deputet fillon të ushtrojë mandatin e tij menjëherë pasi bën betimin, dhe nga ky moment fillon të gëzojë të drejta dhe detyrime të caktuara në lidhje me mandatin e tij;

iii. mandati i një Parlamenti të ri fillon me seancën e tij të parë pasi shpallen rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, dhe vazhdon deri në takimin e parë të Parlamentit të ri.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se nuk pritet që kandidatët në zgjedhje duhet që të heqin dorë domosdoshmërisht nga çdo burim jetese përpara se të zgjidhen, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me të drejtën e tyre individuale për jetën private dhe respektimin e dinjitetit të tyre personal. Sidoqoftë, një Deputet duhet të marrë të gjitha masat që të shmangë çdo situatë mospajtimi ose konflikti i interesave që mund të lind në fillim të një mandati dhe për gjatë të gjithë kohëzgjatjes së mandatit. Masat konkrete për këtë qëllim duhet të merren jo më vonë se momenti kur shpallen rezultatet përfundimtare, në momentin kur Deputeti ka sigurinë dhe është i qartë për të ardhurat e tij financiare.

Gjykata [Kushtetuese] thekson se pasojat juridike të mandatit të Deputetit fillojnë në momentin kur kandidati shpallet Deputet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nga ky moment, Deputeti duhet të përmbushë të gjitha detyrimet kushtetuese dhe ligjore që lidhen me ndalimin për kryerjen e aktiviteteve të tjera, dhe me bërjen publike të interesave të tij financiarë, sipas parashikimit në nenin 70 të Kushtetutës dhe në ligjet e tjera përkatëse.

Koncepti i konfliktit të interesit rregullohet përgjatë sistemeve të ndryshme juridike pjesërisht nga kushtetutat e tyre dhe pjesërisht nga ligje të posaçme. Nëse një aktivitet është në konflikt me funksionin e një Deputeti, kjo nënkupton se ai mund të mos ushtrojë funksionin tjetër, por vetëm funksionin e Deputetit të Parlamentit ose të anëtarit të Qeverisë.

Fokusi kryesor i dispozitave që lidhen me konfliktin e interesave ka dy aspekte: i pari lidhet me ndalimin për mbajtjen e dy funksioneve publike, ndërsa i dyti ka të bëjë me ndalimin për ushtrimin e funksioneve

publike dhe private në të njëjtën kohë. Në të dyja rastet, ndalimi për mbajtjen e funksioneve të dyfishta synon të parandalojë mbivendosjen e pushteteve kur ato i përkasin të njëjtit person ose organ, për të mos shkelur parimin e ndarjes së pushteteve, dhe rrjedhimisht, shtetin e së drejtës. Gjithashtu, ndalimi i kryerjes së më shumë sesa një funksioni shërben edhe për të siguruar angazhimin e plotë dhe të pakursyer të një zyrtari në përmbushjen e detyrave të cilat i janë besuar, që mund të neglizhohen ose të bëhen të pamundura për shkak të angazhimit specifik që mund të nevojitet për kryerjen e njëkohësishme të më shumë sesa një funksioni. Parimi i mospajtueshmërisë mbron ushtrimin e mandatit dhe garanton paanshmërinë e përfaqësuesve të zgjedhur. Ai përbëhet nga pamundësia juridike e mbajtjes së funksionit për të cilin është zgjedhur personi në fjalë dhe [në të njëjtën kohë] të kryerjes së aktiviteteve të caktuara që konsiderohen nga legjislatori si të papajtueshme me mandatit e një Deputeti.

Gjykata [Kushtetuese] thekson se përkufizimi i një konflikti interesi mbështetet kryesisht në parimin e ndarjes së pushteteve, por edhe në parimin e neutralitetit shtetëror, sipas së cili organet shtetërore ose agjentët e tyre nuk duhet të jenë të lidhur me, ose të varur nga, interesa ekonomike. Në lidhje me mbajtjen e më shumë sesa një posti si konflikt interesi, nuk është e nevojshme që një nëpunës publik të bëjë përfitime për shkak të postit [tjetër] të tij, ose që ai të jetë në konflikt interesi, në lidhje me funksionin e tij zyrtar dhe interesat e tij privat. Ky ndalim hyn në fuqi sapo [i njëjti person] ushtron të dyja funksionet (publik-publik, publik-privat). Duke pasur në konsideratë se çështja në fjalë sjell nevojën për të përcaktuar papajtueshmërinë midis shërbimit publik dhe aktivitetit privat të një natyre fitimprurëse që vjen nga pasuritë e Shtetit, Gjykata [Kushtetuese] gjykon se ajo duhet të marrë në konsideratë vetëm këtë aspekt.

Ndalimi i një Deputeti që të angazhohet në një aktivitet privat në përgjithësi nuk është absolut. Disa sisteme juridike evropiane e lejojnë një mundësi të tillë me kufizime të caktuara. Lejimi i një Deputeti [Parlamenti] që të mbajë një licencë për të ushtruar profesionin e tij kryesor mbështetet në parimin se një Deputet nuk duhet të shkëputet plotësisht nga tregu i punës ose të privohet nga mundësia e të ushtruarit të profesionit të tij kryesor vetëm sepse ai merr përsipër të përfaqësojë interesat e njerëzve në organe përfaqësuese. Nga ana tjetër, ndalimi i ushtrimit të një profesioni mbështetet në faktin se funksioni një deputeti është një pozicion me kohë të plotë dhe duhet të trajtohet si i tillë në të gjitha ligjet e Shtetit. Është e nevojshme të mbahet në konsideratë jo vetëm elementi “kohë”, por edhe elementi “pagë”. Funksioni i Deputetit paguhet në përputhje me nivelin ekonomik dhe financiar të vendit. Qëllimi është që një Deputet nuk duhet të shqetësohet për të ardhurat e tij gjatë mandatit, për ta pasur të mundur ta bëjë më mirë detyrën për të cilën është zgjedhur.

Neni 70 § 2 i Kushtetutës ndalon ushtrimin e funksioneve të tjera nga një Deputet. Neni 70 § 3 parashikon edhe se ushtrimi i “aktivitetit fitimprurës që vjen nga prona e Shtetit ose qeveria lokale dhe përfitimi i pasurive shtetërore” është e papajtueshme me funksionin e një Deputeti. Ndalime të tjera parashikohen në ligje specifike. Sipas këtyre dispozitave, Kushtetuta jonë i delegon [rregullimin e] konfliktet e interesit të ligje specifike (neni 70 § 2). Ndalimi i Deputetëve që të kryejnë aktivitete fitimprurëse në rastin kur të ardhurat vijnë nga burimet shtetërore parashikohet nga vet Kushtetuta. Ky ndalim shprehet qartazi dhe pa ekuivoqe nga legjislatori, i cili ka pasur për qëllim të eliminojë plotësisht mundësinë e përdorimit të postit si Deputet si një mundësi e mirë për [të akumuluar] të ardhura private për shkak të pozicionit të favorshëm si anëtar i organit më të lartë përfaqësues.”.

Në lidhje me arsyen se përse pozicioni i një Deputeti nuk mund të mbrohej, Gjykata Kushtetuese vlerëson si në vijim:

“Gjykata [Kushtetuese] vlerëson se momenti kur një Deputet bën betimin shënjon fillimin e ushtrimit të detyrave të tij si Deputet, dhe jo kohën kur ai shpallet si Deputet i Parlamentit [pas krijimit të parlamentit]. Sipas Nenit 71 § 1 të Kushtetutës, edhe pse I. B. bëri betimin si Deputet më 25 shkurt 2010, mandati i tij kishte filluar në momentin e shpalljes nga KQZ-ja për zgjedhjen e tij në Parlament, pra, më 1 gusht 2009 dhe jo ditën kur ai bëri betimin.

Pasi shqyrtoi faktet dhe rrethanat e çështjes konkrete në tërësi, Gjykata [Kushtetuese] konstaton se Deputeti I. B. ishte në konflikt interesi, sipas interpretimit të nenit 70 § 3 të Kushtetutës, në momentin kur mori pjesë në thirrjen për tendera të organizuar nga Bashkia e Durrësit dhe kur ai nënshkroi kontratën me përfaqësuesit e saj (...), pasi ai tashmë ishte zgjedhur dhe shpallur si Deputet.

Kur zgjedhja e tij si Deputet u certifikua nga KQZ-ja, I. B. kishte detyrimin të shmangte çdo formë të konfliktit të interesit. Argumenti i tij kryesor, se në atë periudhë ai nuk ishte Deputet pasi nuk kishte bërë ende betimin, nuk është i mbështetur në fakte. Së pari, mandati i tij kishte filluar më 1 gusht 2009, dhe ai morri të ardhura nga Bashkia e Durrësit më 17 shkurt 2010 dhe 21 maj 2010.

Së dyti, fakti që ai nuk e bëri betimin menjëherë nuk mund të paraqitet si një arsye legjitime pasi kjo gjë ishte rezultat i vendimit të tij personal mbështetur në motive politike që ishin bërë publike pas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Fakti se ai e bëri betimin disa muaj pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga KQZ-ja nuk e përjashtonte atë nga përgjegjësia për të përmbushur detyrimet që vinin nga ai mandat, që kishte filluar muaj më herët.”.

23. Në vendimin e saj nr. 7, të datës 24 shkurt 2016, Gjykata Kushtetuese bëri interpretimin e saj, të nenit 70 § 4 të Kushtetutës, si në vijim:

“Kuvendi vihet në lëvizje nga Kryetari i Kuvendit ose një e dhjeta e anëtarëve të tij; Kuvendi vendos për shkeljen e pikës 3, të nenit 70 dhe, për rrjedhojë, dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, që është i vetmi organ kompetent për vlerësimin e një konflikti interesi midis [aktiviteteve të njëj] Deputeti dhe mandatit të tij si Deputet.”.

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 3, TË PROTOKOLLIT NR. 1, TË KONVENTËS

24. Kërkuesi u ankua për mënyrën sipas së cilës Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar legjislacionin përkatës për vlerësimin e konfliktit të pretenduar të interesit, duke rezultuar në ndërprerjen e mandatit të tij. Ai mbështetej në nenin 3, të Protokollit nr. 1, që parashikon si në vijim:

“Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të organizojnë në intervale të arsyeshme kohore, zgjedhje të lira me votim të fshehtë, në kushte që sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e organit ligjvënës.”.

A. Pranueshmëria

25. Qeveria kundërshtoi pretendimin se kërkuesi nuk kishte më statusin e viktimës pasi pasojat e vendimit të Gjykatës Kushtetuese kishin të bënin vetëm me mandatin e tij për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017, dhe ai kishte mundur të regjistronte dhe të hidhte kandidaturën në zgjedhjet pasuese.

26. Kërkuesi argumentoi se ai ndikohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga gjetjet e Gjykatës Kushtetuese se aktivitetet e tij nuk pajtoheshin me mandatin e tij, duke shkelur të drejtat e tij të garantuara sipas nenit 3, të Protokollit nr. 1.

27. Gjykata thekson se për ta privuar një kërkues nga statusi i viktimës, autoritetet duhet të përmbushin dy kushte: ato duhet të njohin të paktën në thelb, një shkelje të Konventës, dhe duhet t'i ofrojnë kërkuesit “korigjim të mjaftueshëm” (shih *Amuur kundër Francës*, 25 qershor 1996, § 36, *Raportet e Gjykrimeve dhe vendimeve 1996-III*; *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, §44, GJEDNJ 1999-VI; dhe *Rotaru kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28341/95, §35, GJEDNJ 2000-V).

28. Gjykata thekson se autoritetet shqiptare, veçanërisht Gjykata Kushtetuese, as nuk e kanë njohur shkeljen e të drejtave të kërkuesit të parashikuara nga Konventa, dhe as nuk i kanë garantuar korigjim për atë shkelje. Rrjedhimisht, kërkuesi ka humbur statusin e tij të viktimës sipas interpretimit të nenit 34 të Konventës.

29. Për këtë arsye, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë se kërkuesi nuk është më në pozitën e viktimës sipas interpretimit të nenit 34 të Konventës.

30. Gjykata thekson se ankesa e tij nuk është as e pambështetur në fakte dhe as e papranueshme sipas ndonjërit prej arsytimeve të listuara në nenin 34 të Konventës. Për këtë arsye, ankesa duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuesi

31. Në fillim kërkuesi theksoi se ai nuk vinte në pyetje qëllimet e ndjekura nga legjislacioni i brendshëm që i bënin disa aktivitete të papajtueshme me mandatin e një Deputeti, në përmbushje të nenit 70 të Kushtetutës, dhe as nuk kundërshtonte ashpërsinë e sanksionit në rastin e një papajtueshmërie të tillë – ndërprerja e mandatit të Deputetit. Megjithatë, ai argumentonte se interpretimi i Gjykatës Kushtetuese për atë legjislacion në rastin e tij kishte qenë shumë i gjerë dhe i paparashikueshëm.

32. Ai argumentonte se më parë kishte qenë vetëm një vendim i mëhershëm i Gjykatës Kushtetuese që interpretonte nenin 70 të Kushtetutës (shih paragrafin 22 më sipër). Në atë vendim, Gjykata Kushtetuese kishte argumentuar se mandati i një Deputeti fillon kur rezultatet e zgjedhjeve shpallëshin nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kërkuesi në atë çështje kishte qenë partner në një kompani që kishte lidhur kontrata me agjencitë lokale qeveritare për shërbime kompjuterike pasi ai ishte shpallur i zgjedhur si një Deputet. Kërkuesi argumentoi se mandati i tij ishte certifikuar nga Kolegji Gjyqësor Elektorale, më 2 gusht 2013, ndërsa kontratat që Gjykata Kushtetuese gjykonte se e kishin vendosur atë në pozitën e konfliktit të interesit ishin lidhur përpara asaj date. Vendimi

i Gjykatës Kushtetuese në çështjen e tij nuk kishte qenë i parashikueshëm për të ose në përputhje me ligjin. Nga data kur ishte shpallur zgjedhja e tij si Deputet, ai e kishte ndaluar “Abissnet” sh.a. të merrte pjesë në ndonjë prokurim publik ose të lidhte kontrata me institucionet publike për të shmangur ndonjë konflikt me pozicionin e tij të ri. Gjithashtu, ai kishte shitur aksionet e tij në “Abissnet” sh.a., në shkurt 2014, jo për shkak të ndonjë konflikti interesi të perceptuar, por për të siguruar se aktivitetet e kompanisë nuk do të pengoheshin më nga kufizimet e tij kushtetuese.

33. Gjithashtu, kërkuesi argumentoi se Komentari Juridik i Inspektoratit të Lartë nr. 4 ishte i vetmi udhëzues zyrtar për situatat e konfliktit të interesave për zyrtarët publikë, sipas ligjit nr. 9367/2005, dhe nuk trajtonte kontratat që ekzistonin tashmë me autoritetet publike, që ishin lidhur përpara se personi të ushtronte një detyrë qeveritare si konflikt interesash që duhej të zgjidheshin përpara marrjes së detyrës.

34. Kërkuesi theksoi se pasi ishte regjistruar si kandidat për zgjedhjet parlamentare, ai kishte marrë të gjitha masat paraprake dhe kishte treguar një nivel të lartë kujdesi për të shmangur çdo konflikt interesi. Ai i shkroi Inspektoratit të Lartë, më 25 korrik 2013, për të kërkuar këshillim mbi aksionet e tij në një kompani (“Abissnet” sh.a.) që po ekzekutonte kontrata të lidhura më herët për ofrimin e shërbimeve të internetit për institucione publike të caktuara. Kërkuesi argumentoi se Inspektorati i Lartë kishte detyrë statutores, sipas nenit 42/1/f, të ligjit nr. 9367/2005, për të ofruar këshillimin e kërkuar; sidoqoftë, Inspektorati e udhëzoi të kërkonte këshillim nga Parlamenti. Kur ai e bëri këtë gjë, administrata parlamentare e referoi përsëri tek Inspektorati i Lartë.

35. Në mungesë të një këshillimi të qartë zyrtar, kërkuesi ndërmoi hapa për ta ndaluar “Abissnet” sh.a. të lidhte kontrata të tjera me organet publike. Sipas interpretimit të tij të nenit 21/1, të ligjit nr. 9367/2005, ndalimi përkatës bëhej i zbatueshëm nga momenti që një person që kandidonte në zgjedhje për pozicionin e Deputetit shpallej fitues i atij pozicioni parlamentar.

36. Gjykata Kushtetuese gjykante se qëllimi i nenit 70 § 3 të Kushtetutës ishte garantimi se Deputetët nuk do ta përdornin pozicionin e tyre si mjet për të përmbushur interesat e tyre private dhe për të përfutur të mira financiare. Të gjitha të ardhurat e “Abissnet” sh.a. pas datës 2 gusht 2013 kishin ardhur nga kontrata të lidhura përpara asaj date, kur kërkuesi ishte një qytetar privat. Në këtë mënyrë, konstatimi i Gjykatës Kushtetuese në çështjen e tij ishte në kundërshtim me qëllimet që Gjykata Kushtetuese i kishte atribuuar më herët legjislatorit kushtetues kalimin në fuqi të kësaj dispozite.

37. Për më tepër, ai nuk kishte fituar të ardhura nga asnjë prej kontratave të “Abissnet” sh.a. që ishin lidhur përpara datës 2 gusht 2013, pasi kompania nuk kishte shpërndarë ndonjë dividend me aksionerët e saj në periudhën nga data 2 gusht 2013 deri më 6 shkurt 2014, ditë në të cilën ai shiti aksionet e tij.

38. Në vijim, ai argumentoi se ligjërisht nuk kishte qenë e mundur që “Abissnet” sh.a. të tërhiqej nga kontratat që ishin lidhur tashmë me organet shtetërore.

39. Duke pasur në konsideratë dispozitat kushtetuese dhe legjislative të zbatueshme, historikun legjislativ dhe praktikën e Inspektoratit të Lartë në periudhën përkatëse, mënyra sipas së cilës Gjykata Kushtetuese kishte interpretuar nenin 70 § 3 të Kushtetutës nuk mund të kishte qenë e parashikueshme për kërkuesin në atë periudhë.

b) Qeveria

40. Qeveria parashitroi se vet Kushtetuta ishte referenca kryesore për sa kishte të bënte me sigurinë ndaj abuzimit me pushtetin nga Deputetët. Gjithashtu, ligji nr. 9367/2005, që rregullonte me më shumë detaje shmangien e konfliktit të interesit nga të gjithë zyrtarët, ishte komplementar i Kushtetutës. Megjithatë, i vetmi organ që mund të gjykonte në çështjet ku pretendohet për abuzim me pushtetin ose konflikt interesi nga Deputetët ishte Gjykata Kushtetuese.

41. Ndalimi i vendosur ndaj Deputetit ndaj angazhimit në aktivitete që sillnin të ardhura nga pasuritë e Shtetit parashikohej në nenin 70 § 3 të Kushtetutës, dhe për këtë arsye, ishte në nivelin e një norme kushtetuese. Në momentin kur lindi pyetja nëse një Deputet ishte përfshirë në një aktivitet të tillë, Parlamentit iu kërkuar që ta referonte çështjen në Gjykatën Kushtetuese.

42. Çështja e kërkuesit u referua rregullisht pranë Gjykatës Kushtetuese dhe kërkuesi pati mundësinë të paraqiste argumentet dhe provat e tij pranë asaj gjykate. Qeveria argumenton se fakti

se kërkuesi i shiti aksionet e tij në “Abissnet” sh.a., edhe pse me vonesë, sugjeronte se ai kishte qenë në dijeni se mbajtja e atyre aksioneve në pronësi ishte në shkelje të Kushtetutës dhe ligjit, dhe se ishte përgjegjësia e tij të merrte të gjitha hapat e nevojshme për të shmangur një konflikt interesi.

43. Në vijim, Qeveria argumentoi se sipas ligjit nr. 9367/2005, ishte e qartë se një zyrtar nuk mund të zotëronte aksione apo të përfshihej në ndonjë mënyrë në një kompani që përfonte të ardhura nga fondet publike.

44. Qasja e Gjykatës Kushtetuese në çështjen e kërkuesit kishte qenë e parashikueshme duke marrë në konsideratë tekstin e nenit 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencën e mëhershme të Gjykatës Kushtetuese. Neni 70 §§ 2 dhe 3 i Kushtetutës parashikonte se një Deputet nuk mund të ushtronte ndonjë funksion tjetër publik përveç atij të një anëtari të Këshillit të Ministrave dhe nuk mund të kryente aktivitete fitimprurëse që gjeneronin të ardhura nga pasuritë e Shtetit. Kjo dispozitë synonte të parandalonte që zyrtarët e zgjedhur të përdornin funksionin e tyre për të gjeneruar të ardhura për veten ose palët e treta nga pasuritë e Shtetit. Nga ana tjetër, Deputetëve iu lejohej të kishin aktivitete të tjera fitimprurëse që nuk lidheshin me fondet e Shtetit.

45. Në vijim, Qeveria theksoi se neni 28, i Ligjit nr. 9367/2005, e ndalonte një zyrtar të zgjedhur nga sa më poshtë:

- i. Të shërbente si drejtues ose një anëtar i organit drejtues të një organizate fitimprurëse;
- ii. Të ushtronte aktivitete private fitimprurëse, si: person fizik tregtar, avokat, noter publik, ekspert i licencuar ose konsulent, agjent ose përfaqësues i subjekteve fitimprurëse sipas “I”; ose
- iii. Të ishte një aksioner aktiv i një kompanie tregtare që zinte një vend dominues në treg.

46. Qeveria argumentoi se në vendimin e saj të mëparshëm nr. 44, të vitit 2011, Gjykata Kushtetuese kishte mbajtur të njëjtin qëndrim si në çështjen e kërkuesit, më konkretisht se pasojat juridike të mbajtjes së mandatit të deputetit fillonin në momentin kur zgjedhja e një kandidati certifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe se një Deputet duhej të merrte masa konkrete për të shmangur situata papajtueshmërie ose konflikti interesi nga momenti kur shpallehin rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve. Kërkuesi kishte qenë në dijeni për ekzistencën e asaj jurisprudence kushtetuese pasi ai i ishte referuar asaj në parashtrimet e tij përpara Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, kërkuesi nuk kishte ndërmarrë masa pas bërjes publike të zgjedhjes së tij si Deputet për të shmangur konfliktin e mundshëm të interesit për shkak të pronësisë së tij në “Abissnet” sh.a. dhe kontratat vijuese të prokurimeve publike. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, argumenti i kërkuesit se ai personalisht nuk kishte marrë pagesa që vinin nga burime publike ishte e pavend, sepse si aksioner, ai kishte përfituar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë prej tyre. Kushtetuta dhe ligji nr. 9367/2005 parashikonin në mënyrë kategorike se nga momenti që një deputet shpallej i zgjedhur, ai duhej të merrte masa për të ndaluar çdo përfshirje në aktivitete tregtare duke përfituar nga burime shtetërore.

47. Qeveria argumentoi se kërkuesi mund të kishte hequr dorë nga pronësia e tij e aksioneve dhe t’i transferonte ato tek një person tjetër që do t’i mbante aksionet në mirëbesim për kërkuesin.

48. Qeveria arriti në përfundimin se pozicioni i mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në çështjen e tij ishte e parashikueshme për kërkuesin.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

i. Neni 3, i Protokollit nr. 1 në përgjithësi dhe në lidhje me Deputetët

49. Parimet e përgjithshme përkatëse citohen në çështjen *Tabirov kundër Azerbajxhanit* (nr. 31953/11, 11 qershor 2015, si në vijim:

“53. Neni 3, i Protokollit nr. 1 parashikon një parim karakteristik për një demokraci efektive politike dhe është i një rëndësie kryesore në sistemin e konventës (shih *Mathieu-Mobin dhe Clerfayt kundër Belgjikës*, 2 mars 1987, § 47, Seritë A nr. 113). Gjykata përcakton se ai garanton të drejtat individuale, duke përfshirë të drejtën për të votuar dhe për të kandiduar në zgjedhje (ibid., §§ 46–51).

54. Të drejtat e parashikuara në nenin 3, të Protokollit nr. 1, nuk janë absolute dhe ka vend për “kufizime të nënkuptuara”. Në urdhrat e tyre të brendshëm juridikë, Shtetet Kontraktuese mund t’i bëjnë të drejtat për të votuar dhe për të marrë pjesë në zgjedhje subjekt të kushteve që në parim nuk përfshihen në nenin 3. Teksa Shtetet Kontraktuese gëzojnë një margjinë të gjerë vlerësimi në këtë fushë, është Gjykata ajo që përcakton zgjidhjen e fundit, duke pasur parasysh nëse janë respektuar kërkesat e nenit 3, të Protokollit nr. 1. Veçanërisht, ajo duhet të bindet se kushtet nuk cenojnë të drejtat përkatëse në atë masë që të dëmtohet thelbi i tyre dhe t’i privojë ato nga efikasiteti i tyre;

se ato janë vendosur për një qëllim legjitim; dhe se mjetet e përdorur nuk janë disproporcionale (shih *Mathieu Mobin dhe Clerfayt, cituar më sipër*, § 52, dhe *Yumak dhe Sadak kundër Turqisë* [DHM], nr. 10226/03, § 109, GJEDNJ 2008). Këto kushte nuk duhet të cenojnë shprehjen e lirë të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës – me fjalë të tjera, ato duhet të reflektojnë, ose të mos kundërshtojnë - çështjen për të ruajtur integritetin dhe efikasitetin e një procedure elektorale të synuar për identifikimin e vullnetit të njerëzve me anë të së drejtës universale për të votuar (shih *Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 2) [DHM], nr. 74025/01, § 62, GJEDNJ 2005 IX).

55. Shtetet kanë liri veprimi për të përcaktuar rregullat kushtetues për statusin e deputetëve, duke përfshirë kriteret për deklarimin e tyre si të pazgjedhshëm. Këto kritere variojnë sipas faktorëve historikë dhe politikë specifike për çdo Shtet. Me qëllim zbatimit e nenit 3, çdo legjislacion elektoral duhet të vlerësohet sipas evolucionit politik të shtetit në fjalë, në mënyrë të tillë që aspektet që do të ishin të papranueshme në kontekstin e një sistemi, mund të ishin të justifikueshme në kontekstin e një sistemi tjetër (shih *Mathieu-Mobin dhe Clerfayt, cituar më sipër*, § 54; dhe *Melnichenko kundër Ukrainës*, nr. 17707/02, § 55, GJEDNJ 2004 X).

56. Gjykata vëren se mund të vendosen kushte më strikte mbi përzgjedhjen për të kandiduar në zgjedhjet parlamentare, krahasuar me të drejtën për të votuar (shih *Melnichenko, cituar më sipër*, § 57). Nga ai këndvështrim, arrihet në qëndrimin se teksa është e vërtetë se shtetet kanë një margjinë të gjerë vlerësimi kur vendosin kushte zgjedhshmërie në abstrakt, parimi se të drejtat duhet të jenë efektive kërkon që procedura e zgjedhshmërisë të përmbajë siguri të mjaftueshme për të parandaluar vendimet arbitrare (shih *Podkolzina kundër Letonisë*, nr. 46726/99, § 35, GJEDNJ 2002 II, dhe *Yumak dhe Sadak, cituar më sipër*, § 109 (v)).”

50. Në vijim, Gjykata vlerëson se në shqyrtimin e pajtueshmërisë me nenin 3, të Protokollit nr. 1, ajo nuk përdor testimet tradicionale të “nevojës” ose “nevojës shtytëse sociale” që përdoren në kontekstin e neneve 8 deri 11 të Konventës; por ajo përqendrohet kryesisht në dy kritere: nëse ka pasur arbitraritet ose mungesë proporcionaliteti, dhe nëse një kufizim ka ndërhyrë në shprehjen e lirë të opinionit të njerëzve (shih *Yumak dhe Sadak kundër Turqisë* [DHM], nr. 10226/03, § 109 (iii), 8 korrik 2008).

ii. Parimet e përgjithshme, në lidhje me cilësinë e ligjit dhe interpretimi i ligjit të brendshëm

51. Gjykata përsërit se, ndryshe nga dispozitat e tjera të Konventës, teksti i nenit 3, të Protokollit nr. 1 të Konventës nuk përmban një referencë shprehëse për “ligjshmërinë” e cilësdo mase të marrë nga Shteti (shih *Partia Demokratike e Bashkuar Ruse Yabloko dhe të Tjerë kundër Rusisë*, nr. 18860/07, § 75, 8 nëntor 2016). Megjithatë, sipas parimit se kushtet e vendosura në ushtrimin e të drejtave individuale të garantuara nga neni 3, i protokollit nr. 1, mund të mos i cenojnë këto të drejta në atë masë që të cenohet thelbi i tyre dhe t’i privojë nga efektiviteti i tyre, si edhe kërkesa e përgjithshme e Konventës se të drejtat mund të jenë efektive dhe jo zhgënjyese, Gjykata vlerëson se në rastet kur (ashtu si në çështjen konkrete) kufizimet ndaj klasifikimit për të kandiduar në zgjedhje parashikohen me ligj, ligji duhet të përmbushë disa kritere minimale për cilësinë e tij, të tilla si kërkesa e aksesueshmërisë dhe e parashikueshmërisë (shih *Seyidzade kundër Azerbajxhanit*, nr. 37700/05, §33, 3 dhjetor 2009). Gjithashtu, Gjykata i referohet praktikës së saj të konsoliduar me aspektin se një masë e kundërshtuar duhet të ketë disa baza në ligjin e brendshëm dhe duhet të jetë në pajtim me shtetin e së drejtës, gjë që përmendet shprehimisht në Preambulën e Konventës dhe është e pandarë në të gjitha nenet e saj (shih *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë (nr.2)* [DHM], nr. 14305/17, § 249, 22 dhjetor 2020).

52. Në çështjet që kanë të bëjnë me pretendimin për shkelje të nenit 3, të Protokollit nr. 1, Gjykata ka mbajtur në konsideratë rëndësinë e nocionit të “ligjshmërisë” që është thelbësor në Konventë (shih *Adamsons kundër Letonisë*, nr. 3669/03, §§ 116–19, 24 qershor 2008, ku Gjykata në fillim të analizës së saj vlerësoi ligjshmërinë e kufizimit legjislativ ndaj të drejtave pasive elektorale; shih edhe *Yumak dhe Sadak, cituar më sipër*, § 118, ku Gjykata në fillim të analizës së saj vëren se çështja e parashikueshmërisë së masës legjislative për të cilën u bë ankesa nuk ishte në diskutim në atë çështje konkrete).

53. Gjykata vlerëson se ligji është “i parashikueshëm” kur një individ mund – nëse është e nevojshme me këshillimin e duhur – të parashikojë, në një masë të caktuar që është e arsyeshme sipas rrethanave, pasojat që mund të passjellë një veprim i caktuar, dhe përcakton fushëveprimin e diskrecionit ndaj autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme për t’i dhënë individit mbrojtjen e duhur ndaj ndërhyrjeve të arbitraritetit (shih, për shembull, *Selahattin Demirtaş, cituar më sipër*, § 249, dhe *Ljaskaj kundër Kroacisë*, nr. 58630/11, § 65, 20 dhjetor 2016).

54. Megjithatë, shumë ligje janë pak a shumë të paqartë dhe interpretimi e zbatimi i tyre janë çështje e praktikës (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë*, [DHM], nr. 38433/09, § 141, GJEDNJ 2012). Nuk ka rëndësi se sa qartë është hartuar një parashikim ligjor, pasi ekziston një element i pashmangshëm për interpretim juridik. Do të jetë gjithmonë nevoja për të sqaruar pikat e dyshimta dhe për përshtatjen me rrethanat ndryshuese (krahaso, për shembull, *Imeri kundër Kroacisë*, nr. 77668/14, § 75, 24 qershor 2021).

55. Qëllimi i konceptit të parashikueshmërisë varet në një masë të konsiderueshme nga përmbajtja e instrumentit në fjalë, fusha për të cilën është projektuar që të mbulojë, dhe numri e statusi i atyre të cilëve iu adresohet. Fakti se ka mundësi për më shumë se një formulim të një dispozite ligjore nuk do të thotë se ajo nuk përmbush kërkesën për “parashikueshmëri” për qëllimet e Konventës. Roli i gjyqimit, që i është veshur gjykatave, është pikërisht për të hequr dyshimet, duke marrë në konsideratë ndryshimet në praktikën e përditshme (shih *Gorzelik dhe të Tjerë kundër Polonisë* [DHM], nr. 44158/98, § 65, 17 shkurt 2004). Koncepti i “ligjit” përfshin ligjin statutor dhe praktikën gjyqësore (shih *Mullai dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 9074/07, § 113, 23 mars 2010).

56. Interpretimi i këtij kuadri legjislativ nga autoritete e brendshme – kryesisht gjykatat – nuk duhet të jetë arbitrar ose të ketë mungesë proporcionaliteti; këto vendime duhet të jenë mjaftueshëm të arsyetuara (shih *Partia Demokratike e Bashkuar Ruse Yabloko dhe të Tjerë*, cituar më sipër, § 75).

57. Në këtë kontekst, Gjykata përsërit se pushteti i saj për të shqyrtuar pajtueshmërinë me ligjin e brendshëm është i kufizuar. I takon kryesisht autoriteteve të brendshme, më së shumti gjykatave, të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin e brendshëm, edhe në ato fusha ku Konventa “inkorporon” rregullat e atij ligji, pasi autoritetet e brendshme, në natyrën e gjërave, janë veçanërisht të kualifikuar për të zgjidhur çështje që lindin në lidhje me këtë aspekt. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur, si në këtë rast, çështja përqendrohet në aspektin e interpretimit të ligjit të brendshëm kushtetues. Nëse interpretimi nuk është arbitrar ose qartazi i paarsyeshëm, roli i Gjykatës kufizohet në përcaktimin nëse efektet e atij interpretimi pajtohen me Konventën (shih *Radomilha dhe të tjerë kundër Kroacisë* [GHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, § 149, 20 mars 2018).

b) Zbatimi i atyre parimeve në çështjen konkrete

58. Nuk është diskutuar fakti se ndërprerja e mandatit të kërkuesit si Deputet nga Gjykata Kushtetuese kishte shkaktuar një ndërhyrje në të drejtat e tij të mbrojtura nga neni 3, i Protokollit nr. 1. Palët, gjithashtu, ranë dakord se në parim, legjislativi për parandalimin e konfliktit të interesave në lidhje me Deputetët ndiqte qëllime legjitime të tilla si garantimi i paanshmërisë së tyre dhe besimi i publikut në legjislaturë, dhe shmangia e situatave në të cilat ata mund të përdornin pozicionin e tyre për të përfituar nga burimet e Shtetit.

59. Gjykata vëren se problematika kryesore në diskutim në çështjen konkrete është paparashikueshmëria e pretenduar dhe arbitrariteti i masës së marrë (krahaso *Seyidzade*, cituar më sipër, § 32).

60. Në lidhje me këtë aspekt, kërkuesi argumentoi se interpretimi i nenit 70 § 3 të Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese kishte qenë tejet i gjerë dhe i paparashikueshëm. Për këtë arsye, aspekti kryesor i ankesës së kërkuesit kishte të bënte me interpretimin e ligjit përkatës nga Gjykata Kushtetuese.

61. Fillimisht, Gjykata vëren se neni 70 § 3 i Kushtetutës i ndalon Deputetët që të kryejnë një aktivitet që gjeneron të ardhura nga burimet shtetërore. Gjithashtu, neni 21, i ligjit nr. 9367/2005, e bën të qartë se deputetët, ashtu si zyrtarë të tjerë publikë, e kanë të ndaluar të lidhin “një kontratë ose nënkontratë me një institucion publik”; e njëjta gjë zbatohet për cilëndo kompani tek e cila një zyrtar ka interesa pronësie (shih paragrafin 20 më sipër). Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht vendimi i saj nr. 44 (2011) në të cilin përfshihej një Deputet tjetër kompania e të cilit lidhte kontrata prokurimesh me subjektet shtetërore (shih paragrafin 22 më sipër), ishte i qartë në këtë aspekt. Për këtë arsye, në periudhën përkatëse, kishte pak dyshime se pronësia aktive e një kompanie që gjeneronte të ardhura nga kontratat me organet shtetërore përbënte një aktivitet të papajtueshëm me mandatin e në Deputeti sipas ligjit të brendshëm.

62. Së dyti, në çështjen konkrete lind pyetja nëse ndalimi i zbatohet edhe për kontratat që tashmë ekzistojnë me qeverinë të bëra nga kandidati, ose nga një kompani në të cilën ai ose ajo kishte interes pronësie, dhe që priteshin të vijonin të gjeneronin të ardhura pasi ai ose ajo të bëhej Deputet. Nëse po, Gjykata duhet të vlerësojë më tej nëse ishte mjaftueshëm e parashikueshme për kërkuesin se çfarë hapash nevojiteshin që të ndërmerreshin prej tij për të siguruar se ai nuk ishte në një situatë konflikti interesi në realizimin e funksioneve si Deputet.

63. Gjykata vëren se në këtë aspekt, kompania “Abissnet” sh.a., në të cilën kërkuesi ishte aksioner i vetëm, kishte lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve të internetit dhe të telefonisë fikse me autoritete të ndryshme publike përpara se të shpallej fakti se kërkuesi ishte zgjedhur në votime. Kompania vijoi të gjeneronte të ardhura nga këto kontrata edhe pasi kërkuesi nisi mandatin e tij parlamentar.

64. Kërkuesi argumentoi se kompania kishte ndaluar së marrë pjesë në oferta sapo ishte deklaruar se ai ishte zgjedhur në votime. Megjithatë, ai nuk e kishte ngritur në diskutim faktin se kompania kishte vijuar të gjeneronte të ardhura nga kontratat e lidhura më herët me autoritetet publike. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se në vendimin e saj nr. 44 (2011), Gjykata Kushtetuese kishte miratuar një interpretim relativisht strikt të kufizimeve kushtetuese dhe statute për angazhimin e Deputetëve në aktivitete që gjeneronin të ardhura nga pronat shtetërore. Qasja e Gjykatës Kushtetuese mbështetet në interpretimin e nenit 70 të Kushtetutës në tërësi, i cili i ndalon deputetët jo vetëm të përfitojnë nga burimet shtetërore me anë të aktiviteteve të tyre ekonomike, por edhe nga ushtrimi i funksioneve të tjera publike, me përjashtimin e vetëm kur ata shërbenin si anëtar i Kabinetit (shih nenin 70 § 2 të Kushtetutës i plotësuar nga neni 28, i ligjit nr. 9367/2005, i cili e zgjaste përkufizimin e konfliktit të interesit në çdo aktivitet privat me kohë të plotë, paragrafi 20 më sipër). Në vendimin e saj të vitit 2011, Gjykata Kushtetuese i interpretonte këto ndalime si ndalime që përfshinin një Deputet që kishte çdo burim të ardhurash nga portofoli publik pa përfshirë pagën dhe përfitimet e tyre parlamentare (shih paragrafin 22 më sipër). Për Gjykatën Kushtetuese, ajo që ishte vendimtare në çështjen e kërkuesit nuk ishte afati kohor i përmbjlljes së kontratave, por fakti se pagesat shtetërore për kompaninë e përfshirë në këto kontrata kishte vijuar edhe pasi kërkuesi kishte marrë rolin e tij si Deputet. Gjykata nuk konstaton ndonjë element arbitrariteti në këtë qasje.

65. Për sa kishte të bënte me faktin nëse një qasje e tillë do të duhej të kishte qenë e parashikueshme për kërkuesin, Gjykata vëren se kërkuesi duhej të kishte qenë në dijeni të plotë se kontratat në fjalë, e fundit prej të cilave ishte lidhur më 2 gusht 2013, datë në të cilën kërkuesi ishte zgjedhur, do të vijonte të gjeneronte të ardhura në periudhën e mandatit të tij si Deputet. Gjithashtu, duhej të kishte qenë e parashikueshme për të, mbështetur në jurisprudencën kushtetuese të mëparshme dhe në legjislacionin për konfliktet e interesit, se përfitimi nga pagesa të tilla të vazhduara do të konsiderohej si i papajtueshëm me funksionin e tij si Deputet. Në këtë aspekt, ndalimi i vendosur ndaj Deputetëve, me anë të nenit 70 § 3 të Kushtetutës, ishte më i rrepte sesa kufizimet e përgjithshme të zbatueshme për zyrtarët publikë sipas ligjit nr. 9367/2005.

66. Gjykata vëren se në lidhje me këtë aspekt kërkuesi faktikisht kërkoi këshillim juridik nga Inspektorati dhe administrata parlamentare, dhe se fatkeqësisht, asnjë nga këto dy organe nuk ofroi një përgjigje të qartë. Megjithatë, fakti se ai kërkoi një udhëzim të tillë sugjeron se ai ishte në dijeni për të paktën mundësinë se vijimi i pagesave sipas kontratave shtetërore të kompanisë mund të shkaktonin një konflikt interesi me funksionet e tij të mundshme parlamentare. Në të njëjtën kohë, kërkuesi nuk paraqiti shpjegime për mosautorizimin e Inspektoratit nga ana e tij për të realizuar një kontroll formal të situatës së tij të konfliktit të interesit, ashtu siç kërkohet nga ai autoritet (shih paragrafin 10 më sipër).

67. Duke u kthyer tek aspekti i kujdesit nga ana e kërkuesit, Gjykata do të marrë në konsideratë gjetjet e Gjykatës Kushtetuese në vlerësimin nëse ai mori hapat që ishin të nevojshëm për të shmangur konfliktin e interesit që lindte nga pronësia e tij e “Abissnet” sh.a., në përputhje me ligjin dhe praktikën e brendshme. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese kishte marrë vendimin e saj nr. 44 (2011), me argumentin se “një kandidat duhet të marrë të gjitha masat [e nevojshme] për të parandaluar çdo situatë papajtueshmërie ose konflikt interesi që mund të lind

në periudhën e marrjes së mandatit të tij në Parlament”; dhe këto masa, në parim, duhet të jenë në fuqi nga momenti kur Komisioni Zgjedhor i shpallte Deputetët të zgjedhur.

68. Gjithashtu, Gjykata vëren se sipas rregullave të përgjithshëm më fleksibël të ligjit nr. 9367/2005, afati për marrjen e hapave për ndërprerjen e një konflikti të vazhdueshëm interesi është dy muaj nga data e lindjes së konfliktit (shih nenin 38/3 të atij ligji, cituar në paragrafin 20 më sipër). Megjithatë, kërkuesi i shiti aksionet e tij në “Abissnet” sh.a., vetëm më 6 shkurt 2014, që do të thotë më shumë se gjashtë muaj pasi zgjedhja e tij si Deputet ishte shpallur më 2 gusht 2013.

69. Sipas nenit 37/3, të ligjit nr. 9367/2005, pavarësisht pasigurisë nëse ekziston një konflikt interesi, ose marrjes së këshillimit nga një “institucion më i lartë”, përgjegjësia fundore bie mbi zyrtarin i cili në rast dyshimi duhet të marrë të gjithë hapat e nevojshme për të parandaluar çdo konflikt interesi. Në këtë aspekt, fakti se kërkesat e kërkuetit pranë Inspektoratit të Lartë dhe administratës së Parlamentit për një papajtueshmëri të mundshme mbetën pa përgjigje nuk mund të konsiderohet vendimmarrës.

70. Në lidhje me çështjen e aksuesueshmërisë, nuk është kontestuar fakti se dispozitat e Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9367, në përgjithësi ishin të aksesueshme duke qenë se ato ishin botuar. Në lidhje me vendimin nr. 44 (2011) të Gjykatës Kushtetuese, Qeveria pretendoi se kërkuesi i kishte referuar parashtrimet e tij përpara Gjykatës Kushtetuese dhe kërkuesi nuk e ka kundërshtuar këtë deklaram. Në këtë mënyrë, ky vendim ishte i aksesueshëm dhe i ishte bërë i ditur edhe kërkuetit. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka asnjë problematikë në lidhje me aksesueshmërinë e ligjeve dhe praktikës së zbatueshme ndaj kërkuetit në çështjen konkrete.

71. Duke pasur në konsideratë sa më sipër, Gjykata nuk mund të arrijë në përfundimin se vendimi i Gjykatës Kushtetuese sipas së cilit ndërpritej mandati i kërkuetit si Deputet ishte arbitrar ose jo mjaftueshëm i parashikueshëm për kërkuetin.

72. Së fundmi, Gjykata vëren se kërkuesi nuk kishte argumentuar se ndërprerja e mandatit të tij ishte jo proporcional. Rrjedhimisht, nuk ka arsye të mendohet se është penguar në ndonjë aspekt “shprehja e lirë e opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës” (krahaso *Gitonas dhe të Tjerë kundër Greqisë*, 1 korrik 1997, § 44, *Raportet e Gjykimeve dhe vendimeve* 1997-IV).

73. Për këtë arsye, nuk është shkelur neni 3, i Protokollit nr. 1 të Konventës.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS

74. Kërkuesi u ankua se arsyet e Gjykatës Kushtetuese për ndërprerjen e mandatit të tij shkelnin të drejtat e tij, sipas nenit 8 të Konventës i cili parashikon si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

75. Kërkuesi argumentoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për ndërprerjen e mandatit të tij ishte arsyetuar sipas supozimit të padrejtë se ai kishte shfrytëzuar pozicionin e tij për të përvetësuar nga burimet publike. Duke qenë se çështja ishte mbuluar nga media kombëtare, reputacioni i tij ishte cenuar.

76. Qeveria e kundërshtoi atë pretendim.

77. Gjykata përsërit se e drejta për mbrojtjen e reputacionit të dikujt mbulohet nga neni 8 i Konventës, si pjesë e të drejtës për të respektuar jetën private (shih *Chaany dhe të Tjerë kundër Francës*, nr. 64915/01, § 70, GJEDNJ 2004-VI; *Pfeifer kundër Austrisë*, nr. 12556/03, 35, 15 nëntor 2007; *Polanco Torres dhe Movilla Polanco kundër Spanjës*, nr. 34147/06, § 40, 21 shtator 2010; dhe *Annen kundër Gjermanisë*, nr. 3690/10, § 54, 26 nëntor 2015). Në mënyrë që të përdoret neni 8, sulmi ndaj reputacionit të një personi duhet të arrijë një nivel të caktuar problematike dhe të bëhet në një mënyrë që shkakton paragjykim ndaj gëzimit personal të së drejtës për të respektuar jetën private (shih *Delfi AS kundër Estonisë* [DHM], nr. 64569/09, §137, GJEDNJ 2015).

78. Në çështjen konkrete, çështja kryesore që lidhet me Konventën përfshin të drejtat e kërkuetit sipas nenit 3, të Protokollit nr. 1, që tashmë është adresuar nga Gjykata. Ashtu siç adresohet më sipër, kërkuesi nuk e përshtati sjelljen e tij sipas kërkesave të parashikueshme të ligjit, veçanërisht Kushtetutës, që çuan në ndërprerjen e mandatit të tij si Deputet. Gjykata tashmë ka vlerësuar se neni 8 nuk mund të referohet për të bërë një ankesë për humbjen e reputacionit që është pasojë e

parashikueshme e veprimeve të një personi, si për shembull kryerja e një vepre penale (shih *Alex Springer Kovács kundër Hungarisë*, nr. 20487/13, §26, 23 janar 2018). Edhe pse sjellja e kërkuarit nuk arriti në asnjë mënyrë nivelin e një vepre penale, sidoqoftë u konstatua se ai nuk kishte respektuar një ndalim kushtetues.

79. Në praktikën gjyqësore të Gjykatës, mbrojtja e reputacionit të një personi përgjithësisht është adresuar në situatat e pretendimeve faktike të publikuara të një natyre tejet ofenduese saqë në mënyrë të pashmangshme ato kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën private të kërkuarit. Megjithatë, në çështjen konkrete, edhe pse ndërprerja e mandatit të kërkuarit si Deputet duhet t'i jetë bërë me dije publikut të gjerë dhe duhet të ketë shkaktuar pyetje të paktën për sjelljen e tij, kërkuari nuk ka treguar se pasojat e saj kanë përbërë një ndërhyrje të tillë serioze në jetën e tij private që ato të përbënin një sulm të rëndë ndaj reputacionit të tij. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, ndryshe nga deklaratimet e kërkuarit, Gjykata Kushtetuese nuk gjykon se kërkuari ka përdorur pozicionin e tij për të përfituar nga burimet publike, por se kërkuari nuk ka marrë në mënyrë të menjëhershme të gjitha masat e kërkuara ligjërisht për të parandaluar një konflikt interesi që lind midis mandatit të tij si Deputet dhe pronësisë së tij të një kompanie që merret të ardhura nga burimet publike. Gjykata Kushtetuese nuk ngriti pyetjen nëse kontrata e prokurimit në fjalë ishin lidhur përpara se kërkuari të bëhej Deputet. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se kërkuari nuk kishte vepruar me kujdes për të respektuar detyrat strikte të një deputeti të zgjedhur, për sa i përket shmangies së një konflikti interesi. Pasojat e ndërprerjes së mandatit të kërkuarit si Deputet, për sa kishte të bënte me të drejtën e kërkuarit për respektimin e jetës së tij private, janë rezultati i parashikueshëm i sjelljes së tij.

80. Për sa më sipër, kjo ankesë është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3/a dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. E shpall ankesën, në mbështetje të nenit 3, të Protokollit nr. 1, të pranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme;

2. Gjykon se nuk është shkelur neni 3, i Protokollit nr. 1.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 11 qershor 2024, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
SEKRETAR

Jolien Schukking
KRYETAR

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, këtij vendimi i bashkëngjiten opinionet e veçanta të mëposhtme:

- a) Opinioni paralel i Gjyqtarit Serghides;
- b) Opinioni paralel i Gjyqtarit Pavli.

VENDIMI KOKËDHIMA KUNDËR SHQIPËRISË – OPINIONE TË VEÇANTA OPINIONI PARALEL I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Çështja ka të bëjë me largimin e kërkuarit nga detyra si Deputet i Parlamentit nga Gjykata Kushtetuese, sepse ai ishte aksioner në një kompani që kishte lidhur kontrata me autoritete publike për të ofruar shërbime interneti dhe telefonike. Kompania vijoi të gjeneronte të ardhura nga këto kontrata edhe pas zgjedhjes së kandidatit. Kjo ishte në shkelje të ndalimit kushtetues që i ndalonte deputetët të angazhoheshin në aktivitete biznesi që gjeneronin përfitime nga pasuritë e Shtetit. Kërkuari u ankua se largimi i tij nga detyra shkelte të drejtën e tij për të realizuar detyrat e tij parlamentare, në shkelje me të drejtën e tij, sipas nenit 3, të Protokollit nr. 1, të Konventës, dhe cenonte reputacionin e tij në shkelje të së drejtës së tij për të respektuar jetën e tij private, në mbështetje të nenit 8 të Konventës. Gjykata vlerëson se nuk është shkelur neni 3, i Protokollit nr. 1 i Konventës (shih paragrafin 2 të dispozitave operative të vendimit) dhe e rrëzoi ankesën mbështetur në nenin 8 si të papranueshëm (shih paragrafin 1 të dispozitave operative).

2. Unë votova në favor të të dyja dispozitave operative të vendimit dhe do të shpjegoj se përse po jap këtë mendim paralel.

3. Në paragrafin 79 të vendimit, janë dhënë dy arsye për vlerësimin e Gjykatës në paragrafin 80, siç reflektohet në pjesën e dytë të paragrafit 1 të dispozitave operative, se ankesa e bërë në mbështetje të nenit 8 është qartazi e pambështetur në fakte dhe për këtë arsye duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës. Arsyeja e parë është se “kërkuesi nuk ka provuar se pasojat e tij [që do të thotë pasojat e largimit të tij nga detyra si Deputet] përbënin një ndërhyrje të rëndë në jetën e tij private, duke shkaktuar një sulm të rëndë ndaj reputacionit të tij” (paragrafi 79 i vendimit). Arsyeja e dytë është se “Gjykata Kushtetuese vlerësonte se kërkuesi nuk veproi me kujdes për të respektuar detyrat strikte të një deputeti të zgjedhur, në lidhje me shmangien e konfliktit të interesit” (ibid.), dhe se “pasojat e ndërprerjes së mandatit të kërkuesit si deputet në lidhje me të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private, janë rezultat i parashikueshëm i vet sjelljes së tij” (ibid).

4. Teksa unë bie dakord me arsyen e dytë të Gjykatës për konstatimin se ankesa e bërë në mbështetje të nenit 8 është qartazi e pambështetur, unë jam i mendimit se arsyeja e parë nuk do të duhej të ishte referuar. Duke qenë se largimi i tij nga detyra mund të ishte parashikuar si rezultat i sjelljes së tij, veçanërisht për shkak të mosveprimit nga ana e tij me kujdes për t’u pajtuar me detyrat strikte të një deputeti të zgjedhur, në lidhje me shmangien e konflikteve të interesit, kërkuesi nuk mund të shpjegojë në mënyrë të justifikueshme aspektin se ai kishte vuajtur ndërhyrje të rëndë në jetën e tij private, në shkelje të nenit 8 § 1 të Konventës si rezultat i largimit të tij. Në lidhje me këtë, parimi latin, më konkretisht “*ex turpi causa non oritur actio*” (shih *Leksiku ligjor* nga Wharton, 371) është me vend. Në anglisht kjo do të thotë se një paditës nuk do të mund të ndjek lehtësimin dhe shpërblimin juridik nëse padia ka të bëjë me aktin e tij ose të saj delikt. Arsyeja e parë për gjetjen e ankesës bërë në mbështetje të nenit 8 si të papranueshme, në lidhje me mungesën e seriozitetit të ndërhyrjes, me fjalë të tjera pamundësia për të arritur pragun përkatës për të përfshirë nenin 8 (shih paragrafin 77) do të duhej të diskutohej nëse largimi i kërkuesit nga detyra nuk ishte mbështetur në mosveprimin nga ana e tij me kujdes dhe nuk kishte qenë i parashikueshëm prej tij.

5. Rrjedhimisht, arsyetimi i vendimit në paragrafin 79, duke përfshirë arsyen e parë të shpjeguar më sipër, është metodologjikisht dhe konceptualisht i gabuar.

6. Nëse arsyetimi i dytë dhënë në vendim nuk do të ishte i vlefshëm, unë do të kisha gjetur një shkelje të nenit 8 § 1 të Konventës, pasi unë e konsideroj shkarkimin e tij nga roli i tij si deputet si ndërhyrje të rëndë në të drejtën e kërkuesit për të respektuar jetën e tij private sipas parashikimit në Konventë.

VENDIMI KOKËDHIMA KUNDËR SHQIPËRISË – OPINIONE TË VEÇANTA OPINIONI PARALEL I GJYQTARIT PAVLI

1. Unë jam në dakordësi të plotë dhe pa rezerva me rezultatin dhe arsyetimin unanimit të vendimit konkret. Gjykata ka arritur në përfundimin se largimi i kërkuesit nga detyra nga Gjykata Kushtetuese ishte “mjaftueshëm i parashikueshëm”, mbështetur në rrethanat e çështjes dhe në jurisprudencën e mëparshme të asaj gjykate (shih paragrafin 71 të vendimit). Konsideratat e paraqitura në këtë opinion të veçantë nuk kanë ndikim në rezultatin e çështjes konkrete, por lidhen me funksionimin e përgjithshëm të regjimit kushtetues për konfliktet pasurore të interesit të deputetëve.

2. Çështjet si çështja konkrete vijnë në Gjykatë me anë të një rruge të pazakontë, më konkretisht me anë të asaj rruge në të cilën gjykata kushtetuese vendase vepron si gjykatë e shkallës së parë dhe të dytë. Si të tilla, ato përbëjnë sfida të caktuara për gjykatën e lartë vendase, që vepron si tribunal i faktit dhe i ligjit, si edhe Gjykatën e Strasburgut në kapacitetin e saj mbikëqyrës (të pazakontë) si një organ shqyrtues i shkallës së dytë.

3. Arsyet për këtë organizim vijnë nga zgjedhjet e lira të hartuesve vendas të Kushtetutës, të cilët së pari përfshijnë parashikimin për një konflikt interesi në tekstin kushtetues (neni 70 § 3 cituar në paragrafin 19 të vendimit); dhe së dyti, i jep Gjykatës Kushtetuese autoritet të vetëm për të zgjidhur

çdo mosmarrëveshje, në lidhje me kërkesën e asaj natyre (ibid.), një faktor i tretë është se Parlamenti ka zgjedhur të mos miratojë asnjë legjislacion kryesor, apo rregullore tjetër, për zbatimin e nenit 70 § 3 – përveç një parashikimi në Rregulloren e Parlamentit, të shtuar pas fakteve të çështjes konkrete, që trajton ekskluzivisht aspektet procedurale që e referojnë një marrëveshje të tillë në Gjykatën Kushtetuese.

4. Mungesa e një kuadri më të detajuar normativ nënkupton se çdo dhe të gjitha aspektet juridike, duke përfshirë çdo zonë gri me pasiguri të mundshme, në lidhje me zbatimin e nenit 70 § 3 mund të zgjidhet me anë të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese. Kjo mund të realizohet vetëm *ex post facto* duke krijuar të paktën një potencial teorik për pasigurinë juridike në disa skenarë (por nuk ndodh kështu në çështjen konkrete, siç është theksuar tashmë). Nuk ekziston një proces për të kërkuar një opinion të mëparshëm këshillimor nga kjo gjykatë, dhe organe të tjera shtetërore mund të refuzojnë të luajnë një rol këshillimor në mungesën e një udhëzimi të qartë juridik nga arbitri kushtetues ose të çdo aspekti teknik ose specifik të ndalimit.

5. Ashtu siç theksohet në vendimin e sotëm, në Shqipëri ekziston një regjim i gjerë juridik – sipas ligjit nr. 9367 (2005), ndryshuar (shih paragrafin 20 të vendimit) – që rregullon konfliktet e interesit për zyrtarët publikë. Ky regjim juridik është i zbatueshëm edhe për anëtarët e parlamentit, në të njëjtën mënyrë si për zyrtarët e lartë, ose me anë të parashikimeve që rregullojnë specifikisht konflikte të caktuara interesi të Deputetëve (shih, për shembull, nenin 28 të ligjit). Megjithatë, këto parashikime nuk prekin aspektin e papajtueshmërisë, të parashikuar në nenin 70 § 3 të Kushtetutës.

6. Neni 21, i ligjit nr. 9367, përfshin një ndalim të përgjithshëm për zyrtarët e lartë publikë (përfshirë deputetët), ose çdo subjekt tregtar në të cilin ata kanë interesa pronësie, që të lidhin “kontrata ose nënkontrata me cilindo subjekt publik”. Përjashtimet e vetme nga ky ndalim i gjerë përfshijnë kontrata për shërbime që ofrohen për publikun e gjerë në një mënyrë jo preferenciale (për shembull, për furnizimin me ujë dhe kanalizimet), ose në disa situata të caktuara (shih nenin 21(4) të ligjit). Megjithatë, nuk ka një përkufizim në ligjin nr. 9367 se çfarë e përbën “një kontratë ose nënkontratë me një subjekt publik”; ose ndonjë tregues për mënyrën se si ky koncept lidhet me nocionin kushtetues të “aktivitetit fitimprurës që buron nga pasuritë e shtetit”.

7. Rrjedhimisht, as ligji nr. 9367, dhe, në dijeninë time, as ndonjë aspekt tjetër i legjislacionit nuk përfshin parashikime që synojnë të sqarojnë ose përcaktojnë fushëveprimin e ndalimit në nenin 70 § 3 të Kushtetutës, që është lënë në interpretimin e vetëm dhe ekskluziv të Gjykatës Kushtetuese. Këtu mund të argumentohet, edhe me anë të një krahasimi të thjeshtë, se ndalimi kushtetues ndaj “çdo aktiviteti fitimprurës që buron nga prona e Shtetit ose qeveria lokale” është më i gjerë në fushëveprim sesa ndalimi statutor i kontraktuar me subjektet publike. Në aspekte të tjera, ndalimi kushtetues mund të konsiderohet si më pak i rreptë, ose të paktën më pak i rregulluar në mënyrë precize, sesa ndalimi për kontraktimin në ligjin nr. 9367. Për shembull, a shtrihet ndalimi kushtetues te një “aktivitet fitimprurës” që lidhet me një shërbim shtetëror ose përfitim që i ofrohet publikut të gjerë në një bazë jo preferenciale (*krabaso* nenin 21/4/b, të ligjit nr. 9367)?

8. Sipas mënyrës se si qëndrojnë gjërat, nuk është një mbivendosje domosdoshmërisht perfekte midis kufizimeve të përgjithshme për aktivitetet private të zyrtarëve të lartë publikë dhe ndalimit specifik të nenit 70 § 3 të Kushtetutës të rezervuar specifikisht për deputetët. Ky parashikim i fundit mund të zbatohet në një gamë mjaft të gjerë situatash në të cilat deputetët mund të gjykohen të kenë “bërë përfitime financiare” në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga portofoli publik. Është e qartë se qëllimi i ndalimit është brenda margjinës së vlerësimit të *pouvoir constituant* vendas. Në të njëjtën kohë, parimet e shtetit të së drejtës, si edhe jurisprudenca e kësaj Gjykate, kërkojnë që çdo ndërhyrje me ushtrimin e funksionit parlamentar për një mandat të plotë duhet të jetë mjaftueshëm të qartë dhe të parashikueshëm si për deputetët edhe për elektoratin e gjerë.

9. Është e qartë se sipas skemës kushtetuese aktuale, Gjykata Kushtetuese shqiptare do japë gjithmonë fjalën e fundit për faktin nëse deputetët e gjejnë veten në një konflikt interesash pasurorë që do të ishin në kundërshtim me detyrën e tyre sipas nenit 70 § 3. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për çdo rregullim legjislativ të mundshëm ku kërkohet sqarim i termave mbi këtë ndalim kushtetues, pajtueshmëria e të cilit me vet Kushtetutën do të jetë subjekt i shqyrtimit nga gjykata më e lartë në vend. Në të njëjtën kohë, jurisprudenca kushtetuese mbi këto çështje mbetet e kufizuar dhe siç

është vënë re tashmë, ajo mund të trajtojë çdo aspekt të ri ose jo tërësisht të qartë, në lidhje me ndalimin vetëm në një mënyrë *ex post facto*.

10. Si përfundim, sipas mendimit tim, një rregullim legjislativ i detajuar, që do të duhej të përgatitej dhe përditësohej në respekt të plotë me çdo konstrukt kushtetues ekzistues dhe të së ardhmes, do të ishte përfitues për sigurinë juridike në këtë fushë delikate. Ajo që është në rrezik është aspak më shumë sesa një vlerë themelore e demokracisë: garantimi i respektimit të “shprehjes së lirë të opinionit të njerëzve në zgjedhjen e legjislaturës”.